



Shpresë

Botim i Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen"



Takim me përfaqësuesen e HEKS, Madeleine Hirsch



Përfitues i programit

Zhvillime të reja të shoqatës

Viti 2006 ka qenë një vit i mbarë për shoqatën tonë. Kjo si në aspektin e konsolidimit të programit dhe veprimtarisë së shoqatës, po ashtu edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve të reja me partnerë vendas edhe të huaj. Padyshim është hedhur një hap i rëndësishëm përpara në institucionalizimin e shoqatës dhe arritjen e standarteve të kërkuara.

Janë shtruar shinat e bashkëpunimit me Zyrat Rajonale të Punësimit në Tiranë, Shkodër dhe Durrës, si edhe me Bashkinë e Shkodrës, duke bashkërenduar veprimet dhe shërbimet reciproke. Po synohet që këto marrëveshje të bëhen edhe me zyra të tjera rajonale.

Me partnerët e huaj janë nënshkruar tre marrëveshje të reja: me COOPI (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) për Projektin ALBAMAR, që do të asistojë emigrantët e kthyer nga Italia, me VENETO Lavoro për Projektin MIGRAVALUE që synon të krijojë një model të riintegritit social dhe me Këshillin Belg të Refugjatëve për Projektin Asistencë e Individualizuar Riintegrimi pas Kthimit Vullnetar" si edhe është rinovuar kontrata me IOM Tirana për Projektin VARRP.

Eshtë thelluar puna jonë me migrantët e brendshëm, çka u konkretizua më së miri në implementimin e suksesshëm të Projektit "Hidhe Hapin", nga i cili përfituan 50 gra dhe vajza të zonës periferike të Tiranës. Eshtë menduar që ky projekt të shtrihet edhe në zona të tjera.

Natyrisht të gjitha këto arritje na bëjnë krenarë dhe na shtojnë forcat dhe motivimin për të ecur më tej me programet tona në dobi të shtresave në nevojë.

Irena Dono
Drejtoreshë ekzekutive

Në këtë numër

Risia e projektit ALBAMAR?

Faqe 2

Zyrë e re në Shkodër
Marrëveshje bashkëpunimi

Faqe 3

Duke ndjekur ëndrrën

Faqe 4

Takim me ministrin

Faqe 5

Seminar trajnimi në Marok

Faqe 6

Emigrantët në Perëndim...

Faqe 7-8

Projekti "Hidhe Hapin"

Faqe 8-9

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" dhe roli i saj...

Faqe 10

Projekti "MIGRAVALUE"

Faqe 11

Në kërkim të një pune

Faqe 12

Vizitë e një grupi zviceran

Faqe 13

Histori suksesi

Faqe 14

Shërbime

faqe 15

Statistika

faqe 16

Një falenderim i veçantë, shkon te:

HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane)

EED (Ndihma e Kishës Evangjelike Gjermane)

Komisioni Evropian (Programi AENEAS dhe Interreg IIIB CADSES)

IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin)

COOPI (Bashkëpunimi Ndërkombëtar)

që na mbështesin financiarisht

Risia e Projektit ALBAMAR?

Në maj 2006 filloi implementimi i Projektit ALBAMAR në Shqipëri. Për të zbatuar këtë projekt Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" hapi një zyrë të re në Shkodër dhe forcoi kapacitetin e zyrës në Tiranë. Po ashtu në Marok u hapën qendra të reja shërbimesh për emigrantët e kthyer.



Takim me partnerë të huaj

Projekti ALBAMAR synon në përcaktimin e një mbështetje të integruar për emigrantët e kthyer forcërisht ose vullnetarisht nga Italia në vendet e tyre të origjinës, Shqipëri dhe Marok. Qëllimi madhor i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e një kulture të migrimit legal dhe riintegrimin socio-ekonomik të migrantëve të kthyer. Mbështetja konsiston në ofrimin e mundësive për integrim në tregun e punës, asistencë psikologjike, ligjore dhe për biznesin e vogël. Mbështetja psikologjike dhe trajnim profesional do të ofrohen në Itali, me qëllim që të kthyerit të përgatiten për tregun e punës në vendet përkatëse.

Gjithashtu një bazë të dhënash

do të mblidhen në Itali, Shqipëri dhe Marok për të parë lëvizjet e të kthyerve nga emigracioni dhe riintegrimin e tyre, duke siguruar kështu bazat për një monitorim të imtësishëm të qëndrueshmërisë së procesit të kthimit.

Qasja që sjell projekti bazohet në një shkallë të madhe veprimesh shumëplanëshe. Qëndrueshmëria e kthimit analizohet jo vetëm e lidhur me konceptin e kohëzgjatjes, por gjithashtu bazohet në një vlerësim më të gjerë të mbështetur në shkallën e riintegrimin të emigrantëve të kthyer në vendin e origjinës, duke u nisur nga marrja parasysh e faktorëve ekonomikë, socialë, farefisnorë dhe psikologjikë.

Duke e vlerësuar qëndrueshmërinë e kthimit të lidhur me shumësinë e treguesve të përfshirë, mund të të kuptohen më mirë vështirësitë specifike që migrantët me përvoja të ndryshme kalojnë në vendet pritëse dhe për riintegrimin në vendin e origjinës. Në këtë projekt konsiderohet e rëndësishme edhe përfshirja e të rinjve në risk për emigrim të paligjshëm në vendin e origjinës të emigrantëve të kthyer.

Në kuadër të këtij projekti me kohëzgjatje trevjeçare shoqata jonë do të asistojë 450 emigrantë të kthyer nga Italia. Ndiqma do të konsistojë në gjetjen e një vendi pune dhe ofrimin e një pjese të pagës, ofrimin e kurseve të trajnimit, si edhe në këshillim psiko-social dhe ligjor. Personat e interesuar për hapje biznesi të vogël do t'i referohen Partnerit Shqiptar në Mikrokredi. Përfituesit e projektit do të përfshihen gjithashtu në aktivitetet social-kulturale për të promovuar riintegrimin e tyre social.

Në fazën e fundit të projektit është parashikuar të ngrihet një shoqatë emigrantësh të kthyer që do të mbajë lidhje me qendrat e krijuara dhe zhvillojë aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Partnerët e përfshirë në Projektin ALBAMAR janë: Në Itali:

COOPI (Bashkëpunimi Ndërko-mbëtar), SRF (Shoqëria për Kërkim dhe Formim) dhe CNCA, (Koordinimi Kombëtar i Komunitetit të Pritjes). Në Shqipëri:

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" dhe PSHM (Partneri Shqiptar në Mikrokredi).

Në Marok: AFVIC (Shoqata e Miqve të Familjeve të Viktimave të Emigracionit Klandestin) dhe Fondacioni Zakoura Mikrokredi.

ALBAMAR bashkëfinancohet nga Komisioni Evropian, Programi AENEAS.

Zyrë e re në Shkodër



Më 1 korrik u hap zyra e re e Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" në Shkodër.

Stafi i kësaj zyre përbëhet nga një punonjëse sociale dhe një koordinator pune.

Zyra është hapur në kuadrin e projektit "ALBAMAR" dhe shërben për të forcuar kapacitetin e shoqatës. Ajo mbështet kryesisht emigrantët shqiptarë të riadhesuar forcërisht ose vullnetarisht nga Italia, por në të njëjtën kohë është e hapur dhe mirëpret edhe persona të kthyer nga shtete të ndryshme

evropiane, të cilët vijnë për të marrë informacion mbi organizatën dhe programin që ofron ajo.

Mund të themi që njerëzit janë mjaft të interesuar, pasi kjo zyrë është e para e këtij lloji në qytetin e Shkodrës. Në një hark kohor prej dy muajsh kanë ardhur në zyrë rreth 30 persona, 12 nga të cilët kanë hyrë në program. Kjo duhet parë me një sy shumë pozitiv, pasi zyra e Shkodrës është në hapat e para dhe duket mjaft e suksesshme.

Puna me klientët është e bukur, por edhe e vështirë. Gjithsesi, zyra në Shkodër po punon me përkushtim dhe pasion për të qenë vërtet një shpresë për këta njerëz.

Identiteti dhe integrimi i vërtetë i njeriut gjendet pikërisht në vendlindje dhe ky është objektivi kryesor i punës sonë.

Zyra është e hapur çdo ditë nga ora 8.30-16.30 dhe mirëpret të gjithë të interesuarit që aplikojnë në programin tonë të riintegrit.

Adresa: Lagjia "Vasil Shanto", Rruga "16 Nëntori" Pallati Ademi Hyrja I Kati II Shkodër.

*Antonela Melonari
Punonjëse sociale*



Në zyrën e Shkodrës

Marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë dhe Drejtorinë Rajonale të Punësimit Shkodër

Në kuadër të projektit ALBAMAR që po implemetohet kryesisht në qytetet Tiranë dhe Shkodër për të ndihmuar në riintegrimin e emigrantëve të kthyer nga Italia, shoqata jonë e konsideroi të një rëndësie të veçantë të thellojë bashkëpunimet me institucione publike që ofrojnë shërbime sociale për popullatën në nevojë. Për këtë u nënshkruan dy marrëveshje bashkëpunimi në qytetin e Shkodrës përkatësisht me Bashkinë në datë 1/09/2006 dhe Drejtorinë Rajonale të Punësimit më 1/04/2006. Këto marrëveshje synojnë që të krijohen ura komunikimi dhe shkëmbim informacioni midis enteve publike dhe private me shoqatën tonë, me qëllim që të kompletohen shërbimet e ofruara nga secila palë.

Bashkia Shkodër merr përsipër që të referojë persona të kthyer nga migracioni për t'u asistuar nga programi ynë i riintegrit, informim mbi planet dhe hapat e marra nga qeverisja lokale në ndihmë të kategorisë të personave që në aktualisht ndihmojmë si edhe krijimin e mundësisë për të marrë pjesë në tryeza të rrumbullakta apo debate publike që lidhen me çështjet e kthimit nga emigracioni si edhe me ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi rreziqet e migracionit të parregullt.

Me Drejtorinë Rajonale të Punësimit Shkodër bashkëpunimi bazohet në dërgimin e ofertave të punësimit në mënyrë periodike zyrës sonë të projektit në Shkodër, ndërmjetësimin për punësim për personat e kthyer nga migracioni etj.

Deri tani këto bashkëpunime kanë funksionuar efektivisht dhe në një të ardhme të afërt shpresojmë të implementojmë projekte të përbashkëta me këto organe publike.

Duke ndjekur ëndrrën

Kam lindur në Veri të Shqipërisë. Vija nga një familje e thjeshtë (ashtu siç ishin të gjithë në atë kohë në Shqipëri), por e ndershme. Jam edukuar që në vogëli të jem e sjellshme e respektoj të drejtat e tjetrit dhe të mos bëj asgjë që është në dëm të dikujt tjetër. Fatmirësisht ende udhëhiqem nga parime të tilla. Edhe pse jam e rritur, gjithmonë në mendje më kumbojnë këshillat e prindërve.

Në familjen tonë ishim 4 fëmijë, 3 vajza dhe një djalë, i cili erdhi në jetë i fundit, por që është gjithnjë i pari dhe unë jam krenar për të.

Pasi mbarova shkollën e mesme, konkurova për t'u pranuar në Fakultetin e Drejtësisë, i cili ka qenë ëndrra ime, por nuk fitova dhe kështu përfundova te Fakulteti i Filologjisë. Fillova Universitetin e Tiranës në vitin 1997. Kështu fillova të jetoja në Tiranë, ndërsa prindërit në veri. Pas një këmbënguljeje arrita t'i bindja ata të vinin në Tiranë dhe të ishim bashkë. Kështu që u vendosëm në një shtëpi të vogël me qera në periferi të Tiranës. Ajo shtëpi ishte e vogël sa gjysma e asaj që ne kishim më parë, por mendimi që do të jetë e përkohshme na bëri të mos i ndjejmë shumë përmasat e saj. Dhe vërtet ashtu ndodhi: lëvizëm, lëvizëm për vite, derisa sa mundëm të kishim një shtëpi tonën.

Gjatë viteve të universitetit edhe punoja për të siguruar diçka për t'i ardhur në ndihmë vetes dhe familjes. Ndihesha mirë që jetoja me ta dhe i kisha pranë. Më dukej se gjeja mbrojtje, kur më duhej të përballesha me paragjykimet e disa njerëzve, të cilët ne që vinim nga provincat e veriut na identifikonin si "malokë të mirë".

Por kjo nuk zgjati shumë, pasi unë arrita ta prezantoja veten me dinjitet te njerëzit dhe t'u tregoja se fakti nga vjen nuk ka rëndësi dhe se jo çdo gjë që gjallon në veri është e egër.

Fati dhe rastësia e deshën që të gjeja një punë "të mirë" në një institucion të rëndësishëm. Isha më e reja në moshë, rreth 22 vjeç dhe e vetmja nga veriu, kështu që duhet të isha e kënaqur me aq, por nuk ndodhi ashtu: siç thotë edhe Marksi "çdo dëshirë e plotësuar, sjell dëshirën tjetër". Në fakt unë gjithmonë kërkoj të jem në lëvizje për diçka më të mirë nga ajo që kam. Mirëpo nganjëherë ne kemi në dorë argjendin dhe rendim të kërkojmë për të gjetur arin, por vjen fundi i kërkimit dhe ngelim pa njërën dhe pa tjetrën, humbim edhe atë çka kishim...

Në vitin 2004 me ndihmën financiare të vëllait, i cili jetonte në Londër arrita të ikja atje për studime private. Mora një vizë për Angli dhe u nisa, në të njëjtën kohë kur në Shqipëri rreth 20 veta humbën jetën në tentativë për të kaluar ilegalisht kufirin detar, në një natë të ftohtë dhe thuajse të vetëdijshëm për vdekjen e tyre të paralajmëruar. Shteti ishte i paaftë përballë sfidës së dallgëve të mëdha të detit dhe errësirës së tij, ndërsa unë po largohesha në mënyrë komode nga ky vend i vogël, por i çudirave të mëdha. Mendoja se nuk mund t'i shpëtoje kontrastit të Tiranës, diku e varfër dhe diku e pasur, duke shtuar edhe errësirën, baltën, mungesën e ujit, pasigurinë për jetën, me pak fjalë çdo gjë e "mirë" dukej se mungonte.

Të gjithë koleget, shoqet, njerëzit e mi me shikonin me admirim e zili a thua se kisha fituar

llojarinë më të madhe, ngaqë kisha arritur të merrja një vizë studentore, krejt normale kjo për studentët e vendeve të tjera të botës.

Mbërritja në Londër nuk mund të harrohet, ishte një fillim i ri për mua, ashtu mendoja. Edhe pse e mirinformuar për historinë e Anglisë, nuk mund të mos habitesha me arkitekturën e atij qyteti, shtëpitë e vjetra të vëna në një vijë të drejtë, ku çdo njëra prej tyre kishte një kopsht; të dukej sikur banorët ishin vënë në garë kush do ta bënte më të bukur.

Kur shkela në atë tokë, edhe pse nuk e ve në dyshim që edhe atje ajri është i ndotur, më dukej sikur merrja frymë lirshëm, ishte tokë e premtuar për mua. Sa do të doja të rrija përgjithmonë atje, nuk doja t'ia dija për qytetin tim të lindjes, vendin tim të lënë pas, isha në vendin e duhur dhe në atë qytet të madh mund të ecja lirshëm në vendet publike a thua se isha nënshtrëse e vjetër e këtij vendi.

Fillova të ëndërroja si të vendosesha përgjithnjë aty, por fakti që kisha lindur shqiptare nuk ma lejonte këtë privilegj. U përpoqa të gjeja një punë që të mbuloja shpenzimet e jetesës, por nuk ishte e lehtë, megjithatë shpresa se do të rregullohesha një ditë më bënte të mos isha shumë pesimiste. Dëshiroja që të bëja një specializim master, por llogaritjet e mia ishin gabim, më duhej të ekuivalentoja diplomën dhe më pas të aplikoja përsëri në ndonjë universitet privat, që do të thoshte një faturë e shtrenjtë për mua. Nuk më lejohej të aplikoja për mbështetje financiare tek universitetet apo organizata të tjera që jepnin bursa, pasi më duhej të rrija mbi tre vjet me vizë

studentore dhe të fitoja statusin e një studenti të vjetër (home student).

Endrra ime filloi dalngadalë të shuhej, kështu nuk pata zgjidhje tjetër vetëm të kthehesha në Shqipëri. U ktheva me mendimin se ajo kohë që kisha shpenzuar atje do të vlente si një experiencë e fituar në një vend të madh dhe se do të gjeja kësisoj një punë të mirë. Por nuk ndodhi ajo që shpresova. Kur erdha në Shqipëri, m'u desh të qendroja 4 muaj pa punë. Nuk mjaftonte ai shqetësim i madh, por edhe jeta më dukej e padurueshme, ishte një zhgënjim total, humbje për mua, kthim prapa dhe çdo gjë më dukej e keqe, përveç faktit që isha pranë familjes.

Rastësisht u njoha me programin e Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" dhe shkova te kjo shoqatë që hapi dyert për mua. Ishte hera e parë që në Shqipëri gjeja një shërbim të tillë, me një staf të mrekullueshëm që të jep të kuptosh që gjithmonë je i mirëpritur. Shpresë për të Ardhmen më përfshiu në një program 9 mujor dhe më ofroi asistencë sociale për riintegrimin tim në Shqipëri. Ishte me të vërtetë një ndihmë shumë e vlefshme për mua që i bashkohej pagës sime të vogël dhe që më bëri të mos e ndjeja më veten të pavlefshme dhe të pazonjën. Tani i jam rikthyer dëshirës së vjetër, po vazhdoj një universitet privat për drejtësi dhe shpresoj të më sigurojë një të ardhme më të mirë.

Nuk gjej fjalë për të falenderuar dhe vlerësuar veprimtarinë humanitare të kësaj shoqate, ndihmën që po u jep njerëzve në nevojë dhe përkujdesjen si nga ana financiare, po ashtu edhe nga ana psikologjike.

Ju faleminderit Shpresë për të Ardhmen!
Me respekt
Sa.Sadria

Takim me ministrin



Foto nga takimi

Në datë 21 qershor 06 drejtorja ekzekutive e shoqatës dhe nëpunësja e marrëdhënieve me publikun u pritën në një takim nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansve të Barabarta, Z. Kosta Barka. Në takim ishin të pranishëm edhe dy drejtorë të kësaj ministrie.

Ky takim u bë në kuadrin e njohjes dhe certifikimit të shoqatës sonë si OJF që ofron shërbime sociale. Pasi u bë një prezantim i përgjithshëm i aktivitetit të shoqatës dhe projekteve të saj, u kalua në detaje konkrete të punës sonë me emigrantët e kthyer. Ministri u interesua të mësonte mbi numrin e emigrantëve të kthyer të ndihmuar nga shoqata, moshën e tyre, vendin nga ktheheshin etj.

Ministri sugjeroi që OJF-të të bashkëpunojnë me qeverinë vendore. U evidentua fakti që me nënshkrimin nga qeveria jonë të

Marrëveshjeve të Ripranimit me disa shtete evropiane, del si detyrë e rëndësishme institucionalizimi i asistencës ndaj emigrantëve të kthyer që kërkon doemos një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve qeveritare me organizat jofitimprurëse. Por kjo kërkon që OJF-të të plotësojnë standartet e kërkuara. OJF-të duhet të kenë kapacitete dhe rezultate të matshme dhe të tregojnë dobishmërinë e shërbimeve të tyre. Nga ana e vet, ministria kërkon që t'i monitorojë shërbimet e OJF-ve dhe kjo mund të bëhet nëse ato janë të regjistruara në Shërbimin Social Shtetëror.

Në takim u shkëmbyen mendime dhe ide se si mund të vendosen më mirë urat e bashkëpunimit OJF-qeveri, çka do të çonte në përmirësimin e punës dhe arritjen e rezultateve më të mira në ndihmën ndaj njerëzve në nevojë.

Seminar trajnimi në Marok

Shkalla e rritjes së emigracionit gjatë viteve të fundit në të gjithë botën e ka bërë këtë fenomen një nga problemet madhore me të cilin po përballen shumë shtete. Si mund të parashikohet, ulet apo ndalet emigracioni? Që të kthesh një

Tetor 2006 u zhvillua një seminar trajnimi në qytetin Khouribga të Marokut. Ky seminar synonte të shkëmbente informacion dhe eksperiencë midis stafit shqiptar dhe maroken të projektit ALBAMAR lidhur me çështjet e emigracionit, në mënyrë që të vlerësohen eksperiencat më të mira të përfituara në të dy vendet, të cilat do të shërbejnë në parandalimin dhe kurimin e fenomenit. Ky seminar u organizua nga COOPI (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) si faza e parë e një cikli seminaresh, të cilët do të vazhdojnë të zhvillohen në Shqipëri dhe Itali.



Foto nga takimi

përgjigje për pyetjet e mësipërme, së pari duhet të kuptosh fenomenin. ALBAMAR është një nga projektet i cili synon jo vetëm të njohë fenomenin e emigracionit, por edhe ta trajtojë atë.

Projekti ALBAMAR që ka filluar të implementohet nga Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" qysh nga maji 2006 synon të mbështesë riintegrimin social-ekonomik të migrantëve të kthyer nga Italia në vendin e tyre të origjinës, Shqipëri dhe Marok, si dhe të kontribuojë në zhvillimin e një kulture për emigracion të rregullt. Në këtë projekt janë parashikuar edhe shkëmbime transnacionale midis Shqipërisë dhe Marokut.

Në këtë kuadër në datat 30-31


Në seminar merrnin pjesë partnerët e projektit ALBAMAR si edhe përfaqësues nga organizata, të cilat operojnë në fushën e emigracionit në Marok dhe në Algjeri.

Shqipëria dhe Maroku prej vitesh përjetojnë plagën e emigracionit dhe veçanërisht emigracionin ilegal. Ndryshe nga Shqipëria, Maroku është jo vetëm vendi i origjinës për emigrantët marokenë të kthyer në atdhe, por edhe shtet tranzit për emigrantët e Sub Saharasë të cilët përdorin Marokun për të kaluar më pas në Europë. Maroku rrezikon të kthehet në "shtet pritës" për emigrantët tranzitë, të cilët nuk arrijnë të depërtojnë brenda kufirit të rreptë evropian dhe nga ana tjetër nuk pranojnë të kthehen në vendin e tyre për arsye të jetesës së vështirë në vend dhe kushteve klimaterike jo të përshtatshme.

AFVIC (Shoqata për Miqtë dhe Familjet e Viktimave të Emigracionit Klandestin) është shoqata partnere, e cila ushtron aktivitetin e saj në Marok. AFVIC synon: sensibilizimin e popullsisë



Vizitë tek AFVIC



vendase për rrezikun e emigracionit klandestin, ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe veçanërisht opinionit evropian mbi pasojat e vendimeve politike, mbështet zhvillimin në zonat e prekura nga emigracioni, të mbështet familjet e viktimave të emigracionit klandestin, përkrah respektimin e të drejtave të emigrantëve. Rastet dhe shifrat e sjella nga AFVIC ishin vërtet rrëqethëse (5544 të vdekur si rezultat i emigracionit klandestin që nga viti 1988).

Gjatë këtij seminari partneri shqiptar Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" i prezantoi stafit maroken eksperiencën e saj në asistimin e migrantëve të kthyer. Fillimisht u prezantua gjithë aktiviteti i shoqatës dhe më pas u sollën për pjesëmarrësit raste konkrete, të cilat janë asistuar nga projektet e Shpresë.

Paraqitja e eksperiencës së gjatë 7 vjeçare të shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" në fushën e emigracionit u vlerësua shumë nga pjesëmarrësit në seminar.

Eksperiencia marokene dhe shqiptare të vendosura përballë njëra tjetrës sollën problemet, pengesat, vështirësitë e rasteve të vendeve përkatëse.

Seminari u vlerësua nga të dyja palët si i vlefshëm dhe frytdhënës. Pjesëmarrësit patën ç'të mësonin nga eksperiencat e njëri-tjetrit, çka besojmë se do të reflektohet në punën e tyre të mëtejshme në trajtimin e fenomenit të emigracionit.

Ditën e tretë u organizua një vizitë në zyrat e AFVIC ku ne pamë më konkretisht punën e bërë nga kjo shoqatë si edhe takuam përfitues të projekteve të saj.

Brunilda Qevani



Emigrantët në Perëndim

Nën dritat e metropoleve ku zhurmat e jetës rrjedhin shpejt, emigranti shqiptar udhëton nga shtëpia në punë, nga puna në shtëpi, ashtu shpejt si një mekanizëm, si çdo pjesë e jetës atje. Diellin e sheh rrallë dhe atëherë ndodh të jetë krejt i raskapitur. Në Shqipëri dielli ndriçon fort, por është kaq e pamundur ta shijosh kur do. Leja e qëndrimit vonon të dalë, pothuajse ka skaduar afati kur ti e merr në dorë. Nëse ke fatin të kesh dokumente të përhershme, nuk ke mundësinë ekonomike që të planifikosh gjërat sipas dëshirës. Gratë të lodhura si kudo rendin pas dy tre punëve radhazi çdo ditë. Fëmijët janë disi më të shkujdesur. Shkojnë në shkollë, prindërit punojnë shumë që ata të ndjekin kurse suplementare, por janë kaq larg nevojave të vërteta të tyre; tashmë edukimi i tyre i kalon institucioneve shoqërore.

Në këtë mori eksperiencash pak a shumë sa të njëjta dhe të ndryshme në fatin e tyre, emigranti shqiptar mundohet të mos këpusë ato fije të holla që e mbajnë lidhur me vendin e tij. Ekzistojnë nganjëherë organizime në raste festash që i vënë ata në lëvizje të tregojnë përveç mallit edhe atë gjë të mirë të fituar në emigracion. Por jeta vazhdon sërish e vështirë në realitetin e mundimshëm. Dyzimi i personalitetit do të ishte pasoja më pak e keqe e kësaj jete. Çdo njeri ka një punë, nga e cila siguron nevojat bazë të familjarëve të vet, por këtu diçka i mungon. Ndoshta i mungon vendlindja, miqtë e çdo gjë që ka lënë në vendin e vet. Por në ndërgjegjen e vet e di mirë se kthimi që është krejt i lirë nuk do t'i siguronte asgjë nga komforti i përditshëm dhe praktik, me të cilin tashmë është mësuar. Megjithatë ekziston psikoza e një lloji mohimi të vlerave të vendit ku ka emigruar, është punësuar dhe jeton e kjo ndodh derisa përballet me realitetin e vendit të vet.

Emigrantët - Pushimet në Shqipëri

Përveç mallit dhe nostalgjisë për vendin, për njerëzit e afërm që vjen duke u konsumuar, emigranti shqiptar pret një Shqipëri tjetër, sepse shijet i kanë ndryshuar. Duke pasur parasysh shëmbëlltyrat e rregullit e të punës në vendet e perëndimit, e ka të vështirë të përballet dhe pranojë antitezën e madhe, sepse tashmë e ka fshirë nga kujtesa e vet. Ka një rregull brenda vetes tashmë që i dikton një mënyrë ndryshe të të konceptuarit të vetes dhe botës që e rrethon. Por shtang përballë një realiteti që e cilëson si nën nivelin standart që përcakton jetën e vet. Atëherë shfaqet ana tjetër e monedhës në dyzimin e personalitetit të vet. Fillon të mohojë vlerën e realitetit përballë kujtimeve të origjinës që i kanë mbajtur gjallë dashurinë për atdheun. Njerëzit kanë mbetur siç ishin dhe i duken thuajse démodé tashmë dhe vendi një kaos ndërtimeve dhe shkatërrimesh.

Pikat turistike karakterizohen nga e njëjta gjë, aty modernia dhe e prapambetura kanë përfaqësues të denjë për t'u kënaqur dhe për t'u zhgënjyer. Plazhe të caktuara janë vërtet të rralla në origjinalitetin e vet. Kjo e kënaq, por nuk është e gjitha kështu. Megjithatë emigranti i lodhur mendërisht përshtat nevojat dhe dëshirat e veta duke rrënuar në nostalgjitë më të hershme të jetës në vendlindje e duke menduar sigurisht se në xhep ka biletën e kthimit dhe lejen e qëndrimit gjatë.

Emigrantët e kthyer

Emigrantët e kthyer pa dëshirë përbëjnë rastet dërrmuese të emigrantëve që kthehen. Kjo e bën kthimin edhe më të vështirë në mendjen e tyre. Ideja e një kthimi të menduar dhe të dëshiruar do të ishte ndoshta një përlogaritje efikase e asaj çka lënë jashtë dhe çka pret në vendlindje. Duke iu kthyer kësaj shumice dërrmuese, kthimi është vërtet i zyrtë. Përpara një realiteti që nuk ofron prej kohësh atë që pritet, pasiguria ekonomike është një kusht ekzistencial për këta emigrantë. Trauma e përshtatjes në vendlindjen që sa ka ndryshuar po aq dhe ka mbetur pas, vlen për t'u konsideruar. Në rastin më të mirë ekziston mundësia e një vetëpunësimi, gjë kjo që zgjidh për ta problemin e papunësisë. Por ka aq shumë hallka të paligjërura, të pashkruara, që e bëjnë shumë të vështirë iniciativën e lirë dhe investimin në vend! Të ardhurit arrijnë të ndërtojnë shtëpi, por bizneset e vogla nuk i ngrejnë dot kollaj. Gratë pa profesione të caktuara që jashtë vendit kanë mbajtur familjet e kanë plotësuar nevojat e fëmijëve të tyre, gjenden pa rrugëzgjidhje. Realiteti tashmë nuk i ofron shumë mënyra për të mbijetuar.

Dyzimi i personalitetit të emigrantit të kthyer tashmë ka kryer ciklin e vet dhe është kthyer në një zhgënjim të plotë të çdo shprese për t'u rehabilituar sipas standarteve normale të mësuara një herë e një kohë duke i lënë vend kështu një pikëpyetjeje të madhe brenda vetes për atë çka e pret në të ardhmen.

Amalia Bifsha

Projekti "hidhe hapin"



Në kursin e kuzhinës

Projekti "Hidhe Hapin" - Integrimi i grave dhe vajzave migrante të brendshme -filloi në Tetor 2005 me iniciativën e stafit të Projektit „Kape të Ardhmen“ dhe me mbështetjen financiare të HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane) dhe u implementua për një periudhë njëvjeçare deri në Shtator 2006. Në kuadër të këtij projekti u ndihmuan 50 gra dhe vajza nga fshati Laknas, i cili ndodhet 25 km larg Tiranës dhe përfshihet në zonën e Kamzës. Ky projekt synoi që të ofronte një paketë shërbimesh integruese për këtë kategori personash që përfshinte integrimin profesional dhe social.

Fillimisht përfaqësues të projektit kontaktuan dhe morën pjesë në një sërë takimesh me përfaqësues të Bashkisë Kamëz, me qëllim identifikimin e nevojave dhe problemeve të zonës si edhe për hedhjen e themeleve

për një bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen lokale. Një pjesë e përfitueseve të projektit u referuan nga ky organ publik dhe u asistuan nga shoqata jonë që u ofroi shërbime sipas nevojave.

Gjithashtu u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Punësimit në Tiranë për futjen në kurse profesionale (kurse rrobaqepësie dhe kompjuteri) të grave dhe vajzave, si edhe për ndërmjetësimin për punësim nga ana e agjencive të punësimit pas përfundimit të kurseve. Bashkëpunim pati dhe me organizata jo fitimprurëse si Shoqata "Në Dobi të Gruas Shqiptare" për ofrimin e kurseve të kuzhinës dhe parukerisë si edhe me qendra të tjera formimi profesional.

Projekti "Hidhe Hapin" konkretisht ndërmjetësoi për të siguruar pjesëmarrjen në kurse formimi profesional rrobaqepësie,



Pas marrjes së diplomës

parukerie, kuzhine, kompjuteri si edhe gjuhë të huaj të 50 grave dhe vajzave të zonës së Laknasit, duke mundësuar pagesën e kurseve si edhe duke u siguruar transportin gjatë periudhës së ndjekjes së kurseve.

Një aspekt tjetër i punës me këtë target grup është dhe mbështetja psiko-sociale, që iu ofrua përfitueseve të projektit, në

përshtatje me nevojat dhe rastet specifike të ofruara. Tre sesione trajnimesh mbi aspektet e shëndetit, roleve gjinore e dhunës në familje si edhe mbi elementët e vetëprezantimit gjatë një interviste pune u organizuan nga shoqata, ku u përfshinë trajnues ekspertë të fushave përkatëse.

Gjithashtu gratë u përfshinë në takimet „Shtëpia e Hapur“ si edhe

aktivitetet kulturore që shoqata jonë organizon në mënyrë periodike me qëllim që t'u jepej mundësia të ndanin problemet e tyre me të tjerët, si edhe të merrnin informacion mbi aspekte të ndryshme që lidhen me jetën e tyre.

Gjatë implementimit të këtij projekti stafi i shoqatës hasi vështirësi dhe pengesa të ndryshme: për t'i bindur këto gra të merrnin pjesë në program, na u desh të përballëshim me stereotipet e vjetra tradicionale, mentalitetin patriarkal të zonës ku burrat vendosin në procesin e vendimmarrjes në familje, ku roli i gruas në familje është i pakët, gruaja konsiderohet thjesht si shtëpiake dhe rritëse fëmijësh dhe është e kufizuar të veprojë vetëm brenda mureve të shtëpisë. Pengesa të tjera ishin niveli i ulët e besimit ndaj shërbimeve që ofrojnë shoqatat çka vjen shpesh edhe nga mosnjohja e tyre si edhe vështirësi në sigurimin e transportit për arsye të infrastrukturës rrugore të dëmtuar.

Megjithë vështirësitë ne arritëm të realizojmë objektivat tona të këtij projekti: mund të përmendim përfundimin e plotë të kurseve nga të gjitha përfitueset e projektit si edhe punësimin e 62% të tyre në sektorin privat; mundësimin e ndjekjes së kurseve profesionale shtesë specifike në profile të ndryshme për 10 gra përfituese si edhe rritjen e ndërjegjësimin të grave për rolin e tyre në familje dhe shoqëri.

Ne i pamë këto gra të ndryshonin, të organizoheshin në grupe për të shprehur mendime të pjekura për të ardhmen e tyre, ne i pamë ato të ndryshonin pamjen e jashtme, të visheshin më bukur dhe të ishin më të vendosura për të luftuar për të drejtat e tyre.

Seminar me gratë



Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” dhe roli i saj ne institucionalizimin e asistencës për migrantët e kthyer nëpërmjet zyrave lokale të punësimit dhe OJF-ve lokale

Në Dhjetor të vitit 2004 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) filloi zbatimin e një projekti 2 vjeçar “Lufta kundër migracionit të parregullt në Shqipëri dhe në rajon: Mbështetje e shënjestruar për rritjen e kapaciteteve në kuadër të mbështetjes së ripranimit në Shqipëri”, të financuar nga Komisioni Evropian dhe Ministria Greke e Punëve të Brendshme, Administrimit Publik dhe Decentralizimit, i cili synon të mbështesë qeverinë shqiptare për të përmbushur me sukses detyrimet e përcaktuara nga Marrëveshja e Ripranimit me Komunitetin Evropian. Projekti, i cili tashmë është drejt përfundimit përbëhet nga katër komponentë, përfshi

kërkimin mbi politikat e kthimit në Shqipëri, rritjen e kapaciteteve për ripranimin, mbështetjen e Ministrisë së Brendshme për ripranimin, si dhe mekanizmat e riintegritimit për emigrantët shqiptarë të kthyer. Në vazhden e bashkëpunimit institucional me partnerët lokalë për zbatimin e projekteve që nxisin riintegrimin e emigrantëve të kthyer, IOM ftoi pesë shoqata lokale ndër të cilat edhe shoqatën “Shpresë për të Ardhmen” për të kontribuar në hartimin e një dokumenti politik që synonte të ndihmonte në institucionalizimin e asistencës për emigrantët e kthyer në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të strukturave shtetërore për të ofruar shërbime riintegrimi.

Dokumenti Politik pati si qëllim specifik të strukturonte veprimet e ndërmarra për zbatimin e masave të parashikuara nga Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare për Migracionin, veçanërisht masat që lidhen me zgjerimin e shërbimeve të riintegritimit, për të garantuar kthimin e qëndrueshëm. Këto



Foto nga seminari

masa janë mjaft urgjente duke patur parasysh zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian (KE) e cila ka hyrë në fuqi që prej 1 Majit të vitit 2006. Për hartimin e dokumentit u krijua një Task Force e përbërë nga përfaqësues të institucioneve të qeverisë shqiptare, IOM-it dhe 5 OJF-ve të përzgjedhura, të cilat për rreth 7 muaj dhanë kontributin e tyre të vazhdueshëm në paraqitjen e situatës aktuale të shërbimeve të riintegritimit të ofruara në Shqipëri si edhe analizuan perspektivën e këtyre shërbimeve në të ardhmen, dhe rolin që aktorë të ndryshëm mund dhe duhet të luajnë.

Një vëmendje e veçantë në këtë dokument i kushtohet edhe rolit që shoqatat lokale në Shqipëri kanë luajtur në riintegrimin e emigrantëve të kthyer deri më sot si dhe rekomandimeve lidhur me institucionalizimin e bashkëpunimit mes këtyre shoqatave dhe strukturave shtetërore përmes marrëveshjeve kontraktuale formale. Aktualisht hartimi i dokumentit ka përfunduar dhe i është paraqitur Ministrisë së Punës,

Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta sëbashku me kërkesën për ta bërë pjesë të planit të punës të kësaj ministrie dhe strukturave të saj përkatëse (si Shërbimi Kombëtar i Punësimit).

Gjithashtu në vazhden e përpjekjeve për forcimin e strukturave riintegruese në vend, IOM me mbështetjen e Zyrave Rajonale të Punësimit në Tiranë, Durrës dhe Vlorë, si edhe Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” organizoi në muajin Korrik 2006 katër seanca trajnimi me stafin e këtyre zyrave rajonale në lidhje me çështjet migratore dhe politikat/praktikat e rikthimit. Të gjithë pjesëmarrësit në trajnim vlerësuan eksperiencën e IOM dhe të shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” si shumë të vlefshme dhe pararojë në shërbimet që u ofrohen emigrantëve të kthyer.

*Teuta Grazhdani
Eksperte për Çështjet e
Kthimit/
Zhvilluese projektesh IOM.*

Projekti “MIGRAVALUE”

(Orientimi i kohezionit ekonomik dhe social në hapësirën e Vendeve të Adriatikut dhe Evropës lindore; Vlerësimi i Emigracionit si një faktor zhvillimi)



Foto nga takimi me partnerët e përfshirë në projekt

Në zhvillimet e muajve të fundit të aktivitetit të shoqatës sonë është me rëndësi të theksojmë përfshirjen në Projektin MIGRAVALUE. Ky projekt synon që të lançojë një model për një menaxhim aktiv të migracionit si një mjet kyç për një shvillim të integruar ekonomik dhe social në vendet pritëse dhe të origjinës. Projekti ka si qëllim që të zhvillojë vizione hapësinore zhvillimi të lidhura me lëvizjet migratore dhe me strategjitë rajonale të zhvillimit. Bashkëpunimi i ngushtë midis vendeve pritëse dhe të origjinës për arritjen e këtij qëllimi do të rrisë kohezionin midis BE dhe rajoneve në zonën e Adriatikut dhe Evropës Lindore, në përputhje me synimet e politikave të bashkëpunimit dhe integritit hapësinor të përcaktuara në Instrumentin e Ri të Fqinjësisë.

Gjithashtu është parashikuar

mbështetje e investimeve të migrantëve në vendet e origjinës, duke i nxitur ata që të financojnë në ngritjen e bizneseve, duke zvogëluar në këtë mënyrë efektet e rrjedhjes së trurit dhe duke promovuar efektet pozitive të migracionit që përfshijnë njohuritë për metodat e reja të organizimit dhe konkurrencës.

MIGRAVALUE promovon veprimet transnacionale për përfshirje sociale të emigrantëve në zonat e caktuara në projekt, kompletton nxitësit ekonomikë dhe shërbimet me programe të reja të mirëqenies sociale që mund të japin përgjigjet e duhura për nevojat sociale të aktorëve të përfshirë. Projekti synon të krijojë qëndrueshmëri sociale në zonat e përcaktuara si psh në investime ose fondin e kursimeve të një migranti për edukimin e fëmijëve.

Në implementimin e projektit MIGRAVALUE janë përfshirë 14 partnerë nga vende anëtare dhe fqinje të BE, që përfaqësojnë një rrjet të gjerë organizmash publike dhe private, ku përfshihen edhe bizneset dhe migrantët. Ky projekt është i fokusuar në politikat e kthimit të migrantëve dhe në zhvillimin e një rrjeti në nivel rajonal.

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar dy takime në selinë e Veneto Lavoro (Agjencia Rajonale e Punësimit në Rajonin e Veneto-Itali) i cili është partneri lider i projektit, ku morën pjesë të gjithë partnerët e përfshirë në projekt.

Gjatë takimit të parë (25-26 Shtator 2006) u caktua një Komitet Drejtues, me përfaqësues nga të gjitha organizmat partnerë, i cili do të jetë përgjegjës për implementimin e projektit si edhe do të përcaktojë veprimet dhe detyrat e secilit partner. Gjithashtu u diskutuan dhe u përcaktuan në mënyrë përfundimtare paketat e punës dhe kontributi i çdo partneri për një ecuri efektive të planit të veprimit.

Takimi i dytë (10 Nëntor 2006) përcaktoi në mënyrë të detajuar hapat që duhen ndjekur për implementimin e paketës së parë të punës e cila fokusohet në studime dhe analiza të treguesve ekonomikë dhe socialë të secilit vend të përfaqësuar nga partnerët e projektit. Një bord shkencor u krijua me qëllim që të mbikëqyrë dhe orientojë rezultatet e integruara të projektit.

Ky projekt filloi të implementohet në Shtator 2006 dhe është parashikuar të përfundojë në Qershor 2008. Projekti financohet nga KE në kuadër të Programit INTERREG IIIB CADSES.

Në kërkim të një pune

Aty nga fundi i viteve '90 jetoja dhe punoja jashtë vendit, larg familjes dhe të afërmeve të mi.

Sa herë në telefon dëgjoja zërin e vajzës, sytë më lageshin dhe ndjeja një ndrydhje në zemër. E kisha bërë zakon në Tiranë kur kthehesha në shtëpi në mbrëmje e thërrisja vajzën pranë. "Hajde te shoku, se shokun e ka marrë malli, ka gjithë ditën që nuk të ka parë". Ajo ulej pranë meje, mbështeste kokën e vogël në gjoksin tim dhe më pyeste nëse isha lodhur.

Në një nga bisedat e përjavshme aty nga muaji shtator i vitit 2005 i thashë vajzës se "Shokun e kishte marrë malli shumë". "Nuk besoj se ke më shumë mall se unë", tha ajo dhe më tërhoqi vërejtjen se vitet kishin ikur. Ajo tashmë ishte studente e vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe jo më "shoku i vogël". Vërtet vitet kishin vrapuar. Nuk e pashë bijën time si u rrit, nuk ndava me të shqetësimet dhe gëzimet e përfundimit të arsimit tetëvjeçar e të mesëm, nuk e pashë kur ngjiti shkallët e universitetit. Një boshllëk i zyrtë, i dhimbshëm mbeti në zemrën time ato vite që ikën e nuk kanë për t'u kthyer kurrë.

"Kthehu babi, mezi pres që të të shoh!" Lutjet e sime bije vinin si një kushtrim në ndërgjegjen time të lënduar. "Kthehu, Shqipëria ka ndryshuar, nuk është më ajo që ke lënë. Edhe këtu punohet e jetohet, po të kesh vullnetin për punë. Kthehu, kthehu, kthehu..." kjo thirrje e bijës më ndiqte në

çdo hap e çdo çast. Humba qetësinë. Nuk më punohej më. Më mungonin njerëzit, vendlindja, rrugët, fushat, malet, qielli i kaltër, këngët. Kthehu, kthehu...

Në tetor të vitit 2005 vendosa të kthehesha me mall dhe me shpresë në atdhe. "Një punë do ta gjej, tek e fundit jam në vendin tim dhe do ta kem të lehtë të riintegrohem". Kështu mendova dhe shpresova. Por zhgënjimi filloi që ditën e parë ende pa zbritur mirë nga avioni. Në aeroport na preu rrugën policia me një arrogancë dhe egërsi të pajustificuar, sikur të ishim kriminelë të regjur e jo emigrantë të larguar vite më parë për bukën e gojës.

- Çfarë ka ndodhur, zotëri? - pyeta disi i habitur. Por polici ishte i lodhur për të dhënë shpjegime. Na vunë në rresht si ushtarë rekrutë duke na drejtuar për në dhomën e izolimit. Aty kundërmonete tym duhani, në dysheme kishte bishta cigaresh të fikur, të cilët kishin lënë njolla të zeza në të.

- Çfarë ka ndodhur, zotëri? - pyeta përsëri në dëshpërim.

- Ju nuk keni dokumente identiteti, - u përgjegj një polic. -Do të prisni këtu, deri sa të identifikoheni nga rajonet e policisë ku banojnë familjet tuaja.

M'u desh një javë të çmallesha me të afërmit. Fillova të kërkoja punë. Pas dy javësh u punësova në policinë private, pas një muaji më lëvizën në një objekt tjetër, pastaj në një tjetër, në një tjetër dhe një ditë të bukur më thanë se nuk ka më punë.

Fillova të rend rrugëve të Tiranës për punë, por më kot. Punëdhënësit apo bosët, siç jemi mësuar t'i quajmë, matnin me sy fizikun tim dhe përgjigjia ishte: "je i vjetër në moshë, nuk je i fuqishëm, nuk kemi punë, nuk e bën dot punën". Provova të punësohesha si shitës, marangoz, punëtor krahu, roje, por qe e pamundur. Një javë rresht dola çdo mëngjes te "sheshi i krahut të lirë" (ushtari i panjohur) me shpresën e ndonjë pune. Aty gjeta shumë të tjerë, mosha të reja që kishin javë në pritje. Pati nga ata që ironizuan daljen time atje. U largova si një qen i goditur e thellësisht i dëshpëruar. Pas disa ditësh një mëngjes më thërret poshtë ballkonit një i njohur.

- Eja se të kam gjetur punë.

Nuk pyeta fare çfarë lloj pune ishte, mjaft që po dilja nga shtëpia për të punuar.

U bëmë katër vetë dhe shkarkuam diku një maune që qe e mbushur me cigare. Na paguan dymijë lekë. Jo keq për atë ditë, po e nesërmja?! Nuk i humba shpresat. Do ta gjej një punë. Mos u dorëzo, - i thashë vetes. Je rritur me punë.

Një mëngjes shkova në tregjet e shumicës, mbusha çantën me paketa cigaresh, çokollata etj dhe nisa të bëja tregtinë ambulante në rrugë. Medet! - dhe kjo lloj pune paska kusuret e veta, sepse u dashka leje dhe polici është "bosi" i çdo metri katror trotuari. Kisha dëgjuar për bëma policësh, por nuk e pata besuar, deri sa një ditë e provova në shpinën time.

S'mbeti tjetër veç trotuarit. Ushtar i rrugës, ushtar i rrugës, ushtar i rrugës...

A. Alla

Vizitë e një grupi zviceran



asistuar nga shoqata.

Në një nga ditët e vizitës ishte i ftuar në zyrën e shoqatës edhe Z. Sergio Dini, konsull i ambasadës zvicerane në Tiranë si edhe sekretarja e dytë e ambasadës. Staf i shoqatës i informoi të ftuarit mbi projektet e shoqatës dhe më pas të pranishmit kërkuan të dinin mendimet e Z. Dini për situatën në Shqipëri si edhe aktivitetin e ambasadës zvicerane dhe projektet e saj. Biseda u ndoq me mjaft interes nga të pranishmit.

Në fund u bë vlerësimi i vizitës që u konsiderua prej të gjithëve shumë e frytshme dhe e këndshme dhe u dhanë mendime se si mund të bëhet e mundur të jepen më shumë kontribute për shqiptarët e riatdhesuar. U hodh një ide që të krijohet një shoqatë në Zvicër, që do të quhet “Miq të Kape-s”. Kjo shoqatë do të përpiqet për të sensibilizuar opinionin zviceran për nevojat e emigrantëve të kthyer dhe do të mbledhë fonde për të ndihmuar më shumë të rinj në Shkodër, ku sipas vëzhgimit të tyre situata ekonomike është e rënduar.

Nga datat 30 Shtator deri 6 tetor një grup zviceran, i përbërë prej 15 vetësh, vizitoi Shqipërinë. Kjo vizitë është bërë tashmë e përvitshme dhe organizohet nën kujdesin e Z. Patrice de Mestral, i cili është koordinator i projektit “Kape të Ardhmen”. Ardhja e grupeve të tilla ka si qëllim të njohë vizitorët e huaj me Shqipërinë dhe realitetin e saj në përgjithësi si edhe me aktivitetin dhe arritjet e shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” dhe Projektit “Kape të Ardhmen”.

Programi i vizitës përgatitet në mënyrë të atillë që vizitorët të marrin maksimumin e mundshëm të informacionit për Shqipërinë, pra të prekin aspekte të jetës politike, ekonomike dhe kulturore. Kjo bëhet duke vizituar biznese, qendra të ndryshme social-kulturore, shkolla, muze dhe duke zhvilluar takime me personalitete të kulturës si shkrimtari i njohur Fatos Kongoli, regjisori i teatrit Mihallaq Luarasi dhe aktorja Edi Luarasi etj.

Vizitorët ndoqën nga afër zhvillimet e shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”, morën informacion

të hollësishëm për projektet e saj dhe vlerësuan arritjet dhe sukseset në krijimin e partneriteteve të reja dhe zhvillimin e projekteve të reja që kontribuojnë në riintegrimin e emigrantëve të kthyer dhe integrimin e migrantëve të brendshëm.

Vizita u bënë në Tiranë, Berat, Krujë, Shkodër dhe Lezhë ku u takuan edhe mjaft nga klientët e



Histori sukcesi

AGIMI

Agimi është tashmë 41 vjeç, i martuar dhe me dy fëmijë. Familja e tij përbëhet nga pesë persona ku përfshihet edhe e ëma e moshuar. Agimi ka lindur në Dibër, por tani jeton në Tiranë. Ka mbaruar shkollën e mesme bujqësore dhe, para viteve 90-të, ka punuar për nëntë vjet në fabrikën e Pasurimit të Kromit në Bulqizë.

Agimi ka emigruar gjashtë herë në Itali si emigrant klandestin gjatë periudhës 1997 - 2003. Ka kaluar kufirin gjashtë herë me gomone, udhëtim për të cilin ka paguar nga 500 deri në 1000 €. Në Itali ka qëndruar në San Giovanni dhe gjithmonë si emigrant ilegal. Nuk arriti asnjëherë të pajisej me dokumente të rregullta, pasi gjithmonë ndodhte ta kapte policia e ta kthente në Shqipëri.

Gjatë periudhës në emigracion ka punuar në tregun e zi të punës, në ndërtim, frutikulturë, etj. Pesë herë është kthyer forcërisht në Shqipëri, herën e gjashtë dhe të fundit vendosi të kthehej vullnetarisht dhe përgjithmonë në atdhe, pasi e kuptoi se jeta ilegale në emigracion është shumë e vështirë dhe nuk mund të përballohet pa dokumente.

Agimi ishte përfitues i projektit ALNIMA, nga i cili përfituan 21 persona të kthyer nga Italia. Ai u mbështet financiarisht për të mësuar zanatin e rrobaqepësit për gjashtë muaj. Agimi ishte aktiv në të gjitha aktivitetet social-kulturore që organizonte Shoqata. Gjithashtu ai tregonte interes të madh për seminarët e organizuara mbi zhvillimin e një biznesi. Përveç kursit gjashtë

mujor Agimi u referua tek PSHM ku aplikoi dhe mori një mikrokredi. Projekti “Kape të Ardhmen” i dha mundësinë Agimit të blinte një makinë qepëse, të cilën e shleu brenda afatit të caktuar kohor.

Agimi tashmë është një rrobaqepës. Ai ka një rrobaqepësi të vogël ku punon së bashku me gruan dhe kohët e fundit ka punësuar një punonjëse të re.

EDA

Eda është 33 vjeç. Ajo është e divorcuar, ka një djalë dhe jeton sëbashku me prindët e saj. Eda ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, dega Inxhinieri kimike, por nuk e ka ushtruar asnjëherë profesionin e saj. Ajo vendosi të emigronte në Gjermani për mundësi më të mira. Pasi pagoi një shumë të konsiderueshme parash, arriti të shkonte në Gjermani në Prill 1999 së bashku me djalin dhe burrin. Atje u regjistruan si azilkërkues, si shtetas kosovarë, kërkesë e cila iu refuzua më vonë. Gjatë qëndrimit të saj pesëvjeçar në Gjermani (1999 - Janar 2004) Eda nuk punoi asnjëherë. Ajo thjesht kujdesej për familjen, burrin dhe djalin dhe ndoqi një kurs kompjuteri dhe gjuhe. Në Janar 2004 ajo vendosi të kthehej vullnetarisht në Shqipëri së bashku me djalin pas konfliktesh të shumta me bashkëshortin. Eda u kthye në Shqipëri e vendosur për të mos e provuar më jetën ilegale në emigracion.

Eda u mbështet nga projekti “Kape të Ardhmen” për një

periudhë nëntëmuajore për të mësuar dhe punuar në profesionin e faqosës-dizajner. Gjatë kësaj kohe ajo ka marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet social - kulturore që organizonte Shoqata. Duke vlerësuar dëshirën dhe punën e Edës në fushën e dizajnit, projekti “Kape të Ardhmen” i dha asaj mundësinë e një kursi shtesë për kualifikim të metejshëm.

Eda aktualisht punon për një studio grafike. Ajo është tashmë një dezinjatore e mirë që përpiqet gjithnjë e më shumë të thellojë njohuritë e saj në këtë fushë.

VANGJELI

Vangjeli është 24 vjeç. Ai është i pamartuar dhe jeton me prindët dhe dy vëllezër. Vangjeli ka filluar studimet në universitet, por i ka lënë përgjysmë, sepse u detyrua të emigronte në Zvicër për arsye ekonomike. Ka emigruar tre herë dhe gjithmonë në rrugë ilegale. Dy herët e para ka qëndruar vetëm për disa muaj dhe është kthyer forcërisht nga policia zvicerane. Herën e tretë ka vuajtur dënimin në një burg zviceran për një periudhë kohe afërsisht tre vjet e gjysmë. Gjatë burgut ndoqi kursin e gjuhës frënge dhe arriti të fliste rrjedhshëm frëngjisht.

Vangjeli u ndihmua nga projekti “Kape të Ardhmen” për një periudhë nëntëmuajore. Ai përfitoi mbështetje financiare për të lehtësuar studimet në vitin e parë në Universitetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë, dega frëngjisht.

Vangjeli është tani student i frëngjishtes në vitin e tretë, në Universitetin e Gjuhëve të Huaja, Tiranë. Gjithashtu ai punon me kohë të pjesëshme për të përballuar shpenzimet e shkollës.

Shërbime të kryera nga shoqata jonë gjatë vitit 2006

- Mundësi për të mësuar një profesion
- Lehtësim punësimi
- Financim për ndjekje studimesh të larta
- Financim për kurse trajnimi
- Ndihmë ekonomike në raste të veçanta
- Shërbime komunitare (blerje pajisjesh shkollore për fëmijët e klientëve të varfër)
- Aktivitete social-kulturore në ndihmë të riintegritit social
- Këshillim psiko-social
- Këshillim ligjor
- Seminare me gratë migrante të brendshme
- Aktivitete ndërgjegjësuese dhe edukuese për parandalimin e migrimit –ndërgjegjësimi i opinionit publik për rrezikun e migrimit të paligjshëm.



Lajme shkurt



Në 17 tetor 2006 u nënshkrua marrëveshja me Vluchtelingenwerk Vlaanderen (Këshilli Belg i Refugjatëve) për të bashkëpunuar në kuadrin e Projektit “Asistencë e Individualizuar për Riintegrimin pas Kthimit Vullnetarisht”. Ky projekt synon të ofrojë asistencë direkte ose indirekte për emigrantët me qëndrim në Belgjikë, të cilët dëshirojnë të kthehen vullnetarisht, me qëllim që të sigurohet një kthim i qendrueshëm në Shqipëri.

Në 2 Tetor 06 Drejtorja Rajonale e Punësimi në Durrës zhvilloi një panair ku u paraqitën ofertat e punës për rrethin e Durrësit. Shoqata jonë mori pjesë në këtë panair dhe kontribuoi financiarisht për prodhimin e fletëpalosjeve.

Më 27 Prill 2006. shoqata “Shpresë për të Ardhmen” lançoi faqen e saj të Internetit: www.shprese.org



Ne ju japim shpresë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë në Shqipëri

kerko

Home

Organizata

Projekte

Publikime

Staf

Partneret

Foto Galeri


Shpresë për të Ardhmen

Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" është një organizatë jopolitike, jofetare, joqeveritare, jofitimprurëse, social-humanitare, e themeluar në nëntor 1999, e cila ka si qëllim: "Të kontribuojë në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të emigrantëve shqiptarë të kthyer nga vende të ndryshme evropiane, si edhe të ndihmojë në integrimin profesional e social të migrantëve të brendshëm".



Ky qëllim realizohet përmes një një programi të plotë riintegrimi, i cili përfshin: informacion, këshillim dhe mbështetje për riintegrimin profesional, ndihmë në kërkimin e punës dhe integrimin social, parandalim migrimi dhe pritje e

Pershendetje



Patrice de Mestr
Themelues dhe
Projek

STATISTIKA

Në total 1248 persona, 1070 meshkuj dhe 178 femra janë regjistruar në zyrën e Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" që nga Maji 1999 deri në Dhjetor 2006.

878 përfitues, 747 meshkuj dhe 131 femra kanë përfituar nga programi ynë i riintegrimin profesional dhe social deri në Dhjetor 2006.

Statistika të vitit 2006

Nga Projekti "Kape të Ardhmen"

109 pjesëmarrës potencialë (77 meshkuj dhe 32 femra) aplikuan për programin e nxënies së zanatit.

Klientët janë nga 5 rrethe të Shqipërisë: 53 janë nga Tirana dhe rrethinat, 37 nga Shqipëria e veriut, 3 nga Shqipëria e mesme dhe 16 nga Shqipëria e jugut.

67 të rinj përfunduan me sukses programin e mësimin të profesionit, 5 kontrata u ndërprejnë për arsye riemigrimi.

56 të rinj e konsiderojnë mësimin e profesionit si "shumë të dobishëm" dhe 11 si "të dobishëm".

65 përfitues e vlerësojnë shërbimin e zyrës si "shumë të mirë" dhe 2 si "të mirë"

67 të rinj e përfunduan me sukses periudhën 9 mujore të mësimin të zanatit dhe tani 48 prej tyre punojnë në të njëjtin vend pune, 4 punojnë në një vend tjetër dhe 3 janë të vetpunësuar. Pas 9 muajve të ndihmës sonë 3 janë pa punë dhe po kërkojnë një vend të ri pune dhe 9 vazhdojnë studimet e larta.

73 të rinj fituan të drejtën të përfshihen dhe përfitojnë nga programi.

5 përfitues u financuan për të ndjekur kurse trajnimi për kompjuter, patentë dhe gjuhë të huaj dhe ndjekje studimesh të larta.

35 nga klientët e Tiranës janë të ardhur nga Shqipëria e veriut dhe 13 nga Shqipëria e jugut.

Projekte të tjera:

Nga Projekti VARRP, referuar nga IOM


17 klientë (3 femra + 14 meshkuj)

17 kontrata (3 femra + 14 meshkuj)

Nga projekti ALBAMAR

50 klientë (10 femra + 40 meshkuj)

37 kontrata (8 femra + 29 meshkuj)



"Shpresa për të Ardhmen"
Bulevardi "Gjergj Fishta"
Kulla 8, Ap.11, Tiranë
Tel/Faks: (04) 224 033
E-mail: shprese@shprese.org
Web: www.shprese.org